

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **614-26-3668-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me paisje Bujqësore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.
NUI	810396772
Adresa	Xhelal Hajda - Toni
Vendi	Rahovec
Kodi postar	162
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Shkumbin Haxhijaha
Adresa elektronike	info@haxhijaha.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi me paisje Bujqësore

1. Njoftim për Kontratë – 19.05.2026
2. Letër Standarde e sqarimit - 26.05.2026
3. Procesverbali I hapjes së tenderit: 05.06.2026
4. Njoftim për vendimin e AK: 25.06.2026
5. Kërkesë për qasje në dokumentacion: 25.06.2026
6. Përgjigje në kërkesë për qasje në dokumentacion: 26.06.2026
7. Lejimi për qasjen në dokumentacion: 29.06.2026
8. Kërkesë për rishqyrtim: 30.06.2026
9. Vendim në kërkesën për rishqyrtim: 07.07.2026
10. Njoftim për vendimin e AK -Anulim: 08.07.2026
11. Njoftim për vendimin e AK: 16.07.2026
12. Ankesa në OSHP: 17.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

fizikisht nuk kemi qenë por jemi njoftuar përmes eprokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

kemi bere kerkes per rishqyrtim ak-ja e ka cilesuar si pjeserisht te bazuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ankesa mund të dorëzohet, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Ne konsiderojmë që AK ka shkelur dispozitat ligjore në keto Nene:

Neni 1: Qëllimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27: Dosja e Tenderit

Neni 28: Specifikimet teknike

Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60: Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 109: Afatet për Dorëzimin e Ankesës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 25.06.2026, menjëherë pas pranimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit

Kontraktues (AK), kemi paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e procedurës së prokurimit, me qëllim të ushtrimit efektiv të së drejtës sonë ligjore për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues i është përgjigjur kërkesës sonë më datë 26.06.2026, duke na lejuar qasje në dokumentacion vetëm më datë 29.06.2026 në ora 11:00.

Duke pasur parasysh se operatorët ekonomikë, sipas legjislacionit në fuqi, kanë afat ligjor prej 5 (pesë) ditësh për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, konsiderojmë se lejimi i qasjes në dokumentacion vetëm në ditën e katërt të këtij afati ka kufizuar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë tonë për të analizuar dokumentacionin dhe për të përgatitur një kërkesë të argumentuar. Si rezultat, në dispozicion kemi pasur praktikisht vetëm një ditë për shqyrtimin e dokumenteve dhe përgatitjen e kësaj kërkesë.

Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës, kemi konstatuar se Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve nuk ka bërë një ekzaminim të plotë dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Më poshtë paraqesim faktet që mbështesin këtë pretendim:

1. Mosplotësimi i kërkesës nr. 4 të Dosjes së Tenderit

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), në pikat 9.1 dhe 9.2, lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesa nr. 4 përcakton si vijon:

"Kërkesa 4: Deklaratë e ofertuesit për vitin e prodhimit të makinave/pajisjeve të ofertuara, me shkrim nga furnitori, me të cilën konfirmohet se pajisjet janë të reja dhe jo më të vjetra se viti 2025–2026."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Dëshmia 4: Deklaratë për vitin e prodhimit të makinave/pajisjeve të ofertuara, me shkrim nga furnitori, me të cilën konfirmohet se pajisjet janë të reja dhe jo më të vjetra se viti 2025–2026."

Operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka paraqitur një deklaratë në dokumentin e titulluar **"Deklarata nën betim dhe dokumentet tjera"**, konkretisht në faqen 9, ku deklaron vitin e prodhimit të pajisjeve. Megjithatë, kjo deklaratë është hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga vetë operatori ekonomik.

Në asnjë pjesë të ofertës nuk është paraqitur deklarata me shkrim nga furnitori, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e Autoritetit Kontraktues në mënyrën e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Përkundër kësaj, Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve nuk e ka konstatuar këtë mospërputhje dhe e ka

vlerësuar ofertën si të përgjegjshme.

Për këtë arsye, konsiderojmë se operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës është dashur të shpallej operator ekonomik i papërgjegjshëm, pasi nuk ka dorëzuar dëshminë e kërkuar sipas kërkesës nr. 4 të Fletës së të Dhënave të Tenderit.

Lidhur me këtë pretendim tonin, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar atë si të pabazuar, duke arsyetuar se kërkesa e Dosjes së Tenderit: **"Deklaratë për vitin e prodhimit të makinave/pajisjeve të ofertuara, me shkrim nga furnitori, me të cilën konfirmohet se pajisjet janë të reja dhe jo më të vjetra se viti 2025–2026"**, duhet të interpretohet në atë mënyrë që me termin **"furnitori"** nënkuptohet vetë ofertuesi dhe jo furnitori/prodhuesi i pajisjeve.

Me këtë arsyetim nuk pajtohem. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues është e qartë dhe nuk lë hapësirë për interpretim të zgjeruar. Në Dosjen e Tenderit dallohen qartë dy subjekte të ndryshme, përkatësisht ofertuesi dhe furnitori, çka nënkupton se deklaratat e kërkuara nuk mund të konsiderohen si një dhe e njëjta dëshmi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka paraqitur vetëm një deklaratë të lëshuar nga vetë ai, ndërsa nuk ka dorëzuar deklaratë nga furnitori i tij, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, kërkesa e Autoritetit Kontraktues nuk është përmbushur në tërësi.

Prandaj, konsiderojmë se Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve nuk është dashur të bëjë interpretim subjektiv apo zgjerues të përmbajtjes së kërkesës, por të kryejë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave në përputhje strikte me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Çdo interpretim që ndryshon kuptimin e qartë të një kërkesë pas hapjes së ofertave cenon parimet e transparencës, barazisë dhe sigurisë juridike në procedurën e prokurimit publik.

2. Mosplotësimi i kërkesës nr. 7 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FTD)

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës, kemi konstatuar një tjetër mangësi që, sipas vlerësimit tonë, nuk është ekzaminuar në mënyrë të duhur nga Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve.

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), në kuadër të **kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**, kërkesa nr. 7 përcakton si vijon:

"Kërkesa 7: Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë dëshmi se produktet e ofruara janë të destinuara për tregun evropian. Gjithashtu, para nënshkrimit të kontratës duhet të kenë një mostër të pajisjeve në depo."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Dëshmia 7: Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë kopjen e certifikatës CE ose Deklaratën e Konformitetit, si dhe, para nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë në depo së paku një mostër të produkteve të ofruara, e cila do të vlerësohet dhe inspektohet nga Komisioni Vlerësues i Autoritetit Kontraktues."

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, nuk kemi gjetur asnjë deklaratë, zotim apo dokument tjetër të dorëzuar nga operatori ekonomik i propozuar për kontratë, nga i cili do të vërtetohej se ai posedon në depo së paku një mostër të produkteve të ofruara për qëllime të verifikimit dhe inspektimit para nënshkrimit të kontratës, sipas kërkesës së FTD-së.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve nuk e ka shqyrtuar në mënyrë të plotë përmbushjen e kësaj kërkesë dhe, në mungesë të dëshmive të kërkuara nga Dosja e Tenderit, operatori ekonomik i propozuar për kontratë është dashur të shpallej **i papërgjegjshëm**.

Përkundër kësaj, Komisioni e ka vlerësuar operatorin ekonomik si **të përgjegjshëm** dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, pa u siguruar se janë përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për këtë arsye, konsiderojmë se veprimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik dhe përbën shkelje të dispozitave të **Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, përkatësisht të **nenit 1 (Qëllimi)**, **nenit 6 (Ekonomia dhe Efikasiteti)**, **nenit 7 (Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi)**, **nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)** dhe **nenit 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës)**.

-Lidhur me përgjigjen e Autoritetit Kontraktues ndaj pretendimit tonë se operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit lidhur me posedimin e mostrave në depo, pajtohemi në parim me interpretimin e Autoritetit Kontraktues sa i përket përmbajtjes së kërkesës. Megjithatë, për ne mbetet e papranueshme dhe e pajustificueshme mënyra se si Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve, ka konstatuar pas kthimit të lëndës në rivlerësim se operatori ekonomik i propozuar për kontratë e përmbush këtë kriter.

Ne, si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, kemi paraqitur deklaratë me të cilën jemi zotuar se posedojmë pajisjet e kërkuara në depo dhe se ato do të jenë në dispozicion për verifikim para nënshkrimit të kontratës, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Nga dokumentacioni në të cilin kemi pasur qasje, operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka paraqitur një deklaratë të tillë dhe nuk ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë.

Për më tepër, nga dokumentacioni i administruar në këtë procedurë nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka paraqitur ndonjë provë apo dokument mbi bazën e të cilit ka konstatuar se ky kriter është përmbushur. Po ashtu, as operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dokument që do të vërtetonte zotimin ose posedimin e

pajisjeve në depo për qëllime të verifikimit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se konstatimi i Komisionit për Vlerësimin e Tenderëve nuk mbështetet në prova objektive dhe dokumentacion të administruar në dosjen e tenderit. Së paku, operatori ekonomik i propozuar për kontratë është dashur të paraqiste një deklaratë me shkrim, me të cilën do të zotohej se posedon pajisjet e kërkuara në depo dhe se ato do të jenë në dispozicion për verifikim para nënshkrimit të kontratës, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

3. Mospërmbushja e kërkesave lidhur me specifikimet teknike të pajisjeve të ofruara

Në **Dosjen e Tenderit**, përkatësisht në **Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristikat teknike minimale që duhet t'i plotësojnë pajisjet/mekanizmat bujqësorë që janë objekt i kësaj procedure të prokurimit.

Gjithashtu, në **Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD)**, në pikat **9.1** dhe **9.2**, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar:

"Kërkesa 3: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin së paku nga një fotografi të pajisjeve që ofrojnë."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Dëshmia 3: Fotografitë me specifika teknike, të cilat i përshtaten specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit."

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës, kemi konstatuar se dokumenti i paraqitur me specifikat teknike nuk përmban karakteristikat teknike të pajisjeve konkrete të ofruara, por përbëhet nga një riprodhim pothuajse i plotë i specifikimeve të përshkruara në Dosjen e Tenderit.

Operatori ekonomik nuk ka identifikuar qartë markën, modelin dhe specifikat teknike konkrete të pajisjeve që ofron, në mënyrë që Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve të mund të verifikonte përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Në mungesë të këtyre të dhënave, mbetet e paqartë se mbi çfarë baze Komisioni ka konstatuar se pajisjet e ofruara i plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. Për më tepër, pajisjet mekanike bujqësore dallojnë në karakteristikat teknike, performancën dhe çmimin, varësisht nga marka, modeli dhe konfigurimi i tyre. Pa identifikimin e këtyre elementeve, është e pamundur të bëhet një vlerësim objektiv i përputhshmërisë së ofertës me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Komisioni për Vlerësimin dhe Ekzaminimin e Tenderëve nuk ka bërë një vlerësim të plotë dhe objektiv të dokumentacionit të operatorit ekonomik të propozuar për kontratë. Në këto rrethana, operatori ekonomik është dashur të shpallej **i papërgjegjshëm**, pasi nuk ka ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për të provuar se pajisjet e ofruara përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, dhe procedura e vlerësimit është dashur të vazhdojë me operatorin ekonomik të radhës që plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

-Lidhur me përgjigjen e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se operatori ekonomik i propozuar për kontratë e ka përmbushur këtë kriter. Në fakt, ne asnjëherë nuk kemi kontestuar se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë. Pretendimi ynë ka qenë se dokumentacioni i paraqitur nuk dëshmon në mënyrë të qartë dhe të saktë pajtueshmërinë e pajisjeve të ofertuara me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Konkretisht, operatori ekonomik ka paraqitur fotografi të pajisjeve dhe specifikime teknike të cilat janë pothuajse identike me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ai ka riprodhuar kërkesat e Dosjes së Tenderit, pa specifikuar karakteristikat teknike reale të pajisjeve të prodhuesit apo të furnitorit nga i cili pretendon se do të furnizohet.

Për ne është e papranueshme që një operator ekonomik, i cili pretendon se ka identifikuar pajisjet që oferton, të mos paraqesë parametrat e saktë teknikë të tyre, por të përdorë vetëm kufijtë minimalë dhe maksimalë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Çdo prodhues i pajisjeve i përcakton në mënyrë të saktë dimensionet, kapacitetet dhe karakteristikat teknike të produkteve të tij, prandaj operatori ekonomik është dashur t'i paraqesë këto të dhëna sipas specifikimeve reale të prodhuesit.

Për më tepër, nëse i referohemi vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 16.07.2026, në të cilin pretendohet se Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve, pas kthimit të lëndës në rivlerësim, ka konstatuar se operatori ekonomik i posedon këto pajisje, atëherë është edhe më e pakuptueshme se si nuk janë paraqitur dimensionet dhe karakteristikat e sakta të pajisjeve që pretendohet se gjenden në posedimin e tij. Nëse pajisjet ekzistojnë dhe janë identifikuar, parametrat e tyre teknikë duhet të jenë të njohur dhe të dokumentuar me saktësi.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se çmimi i pajisjeve ndryshon varësisht nga dimensionet dhe karakteristikat teknike të tyre. Pranimi i specifikimeve të shprehura vetëm me vlera minimale dhe maksimale i krijon operatorit ekonomik mundësinë që, gjatë realizimit të kontratës, të furnizojë pajisje me parametra të ndryshëm nga ata që mund të jenë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të ofertës. Një situatë e tillë cenon parimin e sigurisë juridike, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për këto arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues është dashur ta vlerësojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë se operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka dëshmuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme përputhshmërinë e pajisjeve të

ofertuara me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

4. Shkelja e nenit 109 të LPP-së – Afatet për dorëzimin e ankesës

Sipas nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, çdo palë e interesuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rishqyrtim, pa pagesë, në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit, lidhur me çdo veprim apo mosveprim të Autoritetit Kontraktues që pretendohet se është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik apo aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, ne kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim brenda afatit të paraparë me ligj, ndërsa më datë **07.07.2026** kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimet tona.

Neni 109 i LPP-së, që rregullon afatet për dorëzimin e ankesës pranë OSHP-së, në paragrafin 1 përcakton se:

"Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së."

Ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se:

"Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji."

Duke qenë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë më **07.07.2026**, afati ligjor prej dhjetë (10) ditësh për paraqitjen e ankesës pranë OSHP-së përfundonte më **17.07.2026**.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore në dy raste:

- më **08.07.2026**, ka nxjerrë vendim për anulimin e vendimit të mëparshëm; dhe
- më **16.07.2026**, ka nxjerrë një vendim tjetër, pa pritur përfundimin e afatit ligjor prej dhjetë (10) ditësh, gjatë të cilit palët kishin të drejtë të ushtronin mjetin juridik pranë OSHP-së.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh edhe me vetë këshillën juridike të përfshirë në vendimin e datës 07.07.2026, ku thuhet:

"KUNDËR KËTIJ VENDIMI PALËT E PAKËNAQURA MUND TË

PARASHTROJNË ANKESË PRANË OSHP-së."

Pavarësisht kësaj këshille juridike, Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar të drejtën e palëve për ta shfrytëzuar afatin ligjor të ankimimit. Përkundrazi, pa përfunduar afati i paraparë me nenin 109 të LPP-së, ai ka nxjerrë dy vendime të reja, duke e bërë praktikisht të pamundur ushtrimin efektiv të së drejtës për ankimim ndaj vendimit të datës 07.07.2026.

Konsiderojmë se një veprim i tillë përbën shkelje të nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik, cenon sigurinë juridike dhe të drejtën e palëve për mbrojtje juridike efektive, si dhe bie ndesh me parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e kësaj procedure, krijohet bindja se këto veprime të Autoritetit Kontraktues kanë pasur për efekt favorizimin e operatorit ekonomik të propozuar për kontratë, pavarësisht mangësive dhe mospërputhjeve të evidentuara në ofertën e tij. Për këtë arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë këto shkelje procedurale dhe t'i vlerësojë ato gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të Autoritetit Kontraktues.

Konkluzion

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, në mënyrën e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave nga Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve, në shkeljet e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të cekura më lart, si dhe në cenimin e së drejtës sonë për ushtrimin efektiv të mjetit juridik pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), konsiderojmë se vendimet e Autoritetit Kontraktues janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga OSHP që:

1. Të aprovojë si të bazuar ankesën tonë;
2. Të pezullojë aktivitetin e prokurimit deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar;
3. Të anulojë vendimet e Autoritetit Kontraktues të nxjerra në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik;
4. Të urdhërojë kthimin e lëndës në rivlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ta bëjë në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pa interpretime që ndryshojnë kuptimin e kërkesave të tenderit;
5. Të konstatojë se operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe, për pasojë, të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit;
6. Pas përjashtimit të operatorit ekonomik të papërgjegjshëm, të vazhdohet me vlerësimin e operatorëve të tjerë ekonomikë përgjegjës, në përputhje me renditjen dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Ligjin për Prokurimin

Publik.

Konsiderojmë se vetëm një vendimmarrje e tillë do të siguronte respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mbrojtjen e integritetit të procedurës së prokurimit public

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K. konsideron se kjo menyre vleresuese e demton kompaninë të cilat ka përfshirë shumë vjeqare në furnizim dhe në këtë mënyrë na pamundëson ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe në të cilat është investuar në staf të trajnuar. Dëmet tjeter materiale konsistojnë në koston e pagimit të tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjedhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*